



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29 Mars 2021

Nr: 191

VENDIM

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 148, DATË 16.03.2021 “PËR CAKTIMIN E
VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V Ë R E N

Vendet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, janë përcaktuar me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 148, datë 16 Mars 2021, “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, sipas lidhjes 1 të tij. Bazuar në listen e derguar të objekteve nga Prefekti i qarkut Shkodër, për VNV e KZAZ-së nr.03, është caktuar palestra e shkollës “Arben Broci”.

Prefekti i qarkut Shkodër me shkresën nr.2476 prot., datë 23.03.2021, i mbështetur në kërkesën e paraqitur nga KZAZ nr.03, si objekt të përshtatshëm për caktimin e VNV-së së ZAZ nr. 03, referon Palestrën e shkollës “Shenjaze Juka”, duke argumentuar se:

- ndodhet me distancë më të afërt me qendrat e votimit;
- ka hapësirë më të përshtatshme për të përmbushur masat anti-covid;
- ka ndriçim dhe kushte më të favorshme për VNV;



Ky objekt, sikundër mjedisi përkatës për caktimin e VNV-së, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor. ZAZ nr. 03 ka 49 QV, dhe mjedisi në këtë objekt është me sipërfaqe mbi 150 m2, plotëson kriteret teknike të përcaktuara në Vendimin e Komisionit Rregullator nr.3, datë 9.02.2021 “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”. Bashkëlidhur shkresës së Prefektit të Qarkut Shkodër, është depozituar relacioni i specialistit rajonal, si dhe kërkesa e KZAZ-së nr.03.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSA:

1. Në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit nr. 148, datë 16 Mars 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:
 - a) Në Qarkun Shkodër, në KZAZ-në nr.03, objekti i propozuar për VNV, Palestra e Shkollës “Arben Broci” zëvendësohet me Palestrën e Shkollës “Shenjaze Juka”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

